

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

DREJTORIA E POLITIKËS MONETARE DHE E HULUMTIMIT



Treguesit më të rinj makroekonomikë
Rishikimi i gjendjes aktuale

Shtator, 2023

Treguesit më të rinj makroekonomikë

Rishikimi i gjendjes aktuale – ndikimi ndaj politikës monetare

Rishikimi i gjendjes aktuale synon të japë një pasqyrë të të dhënave më të fundit makroekonomike (qershor 2023 – gusht 2023) dhe një krahasim me projeksionet më të fundit makroekonomike (prill 2023). Kjo do të vërtetojë se si gjendja aktuale e ekonomisë korrespondon me lëvizjet e pritshme të variablave në ciklin e fundit të projeksioneve. Rishikimi është përqendruar në ndryshimet e supozimeve dhe të realizimeve të jashtme në variablat e brendshme dhe si janë pasqyruar këto ndryshime në mjedisin e drejtimit të politikës monetare.

Vlerësimet e rritjes së ardhshme të ekonomisë globale janë të ngjashme si më parë dhe rreziqet vazhdojnë të jenë në rënie dhe lidhen kryesisht me mbajtjen afatgjatë të inflacionit të lartë dhe me rritjen eventuale më të fortë të normave të interesit, me efekte të pafavorshme në borxhin dhe stabilitetin financiar. Rreziqet e tjera lidhen me luftën në Ukrainë, rritjen e tendosjeve gjeopolitike, kufizimet tregtare dhe ndryshimet klimatike.

Shikuar përmes treguesve të veçantë sasiore të mjedisit të jashtëm, të rëndësishme për ekonominë maqedonase për periudhën 2023 - 2024, rritja e vlerësuar e **kërkesës efektive të huaj** është rishikuar në rënie në krahasim me vlerësimet e prillit, për shkak të përkeqësimit të pritshmërive për vitin 2024, ndërkohë që projeksioni i **inflacionit efektiv të huaj** është korrigjuar në rritje, para së gjithash për vitin 2023. Pritet një zhvlerësim i mëtejshëm i dollarit amerikan ndaj euros, ndërsa **çmimet botërore të prodhimeve parësore** janë rishikuar kryesisht në rënie, më saktë drejt rënies më të thellë. Megjithatë, lëvizjet dhe vlerësimet e çmimeve të produkteve parësore janë jashtëzakonisht të luhatshme dhe nën ndikimin e fuqishëm të zhvillimeve që lidhen me luftën në Ukrainë, e që krijon pasiguri të madhe për dinamikën e tyre të së ardhmes dhe efektet në ekonominë globale dhe vendase.

Sa u përket vlerësimeve të politikës së ardhshme monetare të BQE-së, projeksionet e fundit për **normën e huaj të interesit EUROBOR**, me maturim njëmuajor për vitin 2023 dhe 2024, janë rishikuar në rritje, në përputhje me pritshmëritë për një rritje të normave të interesit referencë të BQE-së. Kështu, në mbledhjen e shtatorit, BQE-ja mori vendimin për rritjen e normave të interesit për 0,25 pikë përqindjeje, në përputhje me vlerësimet për mbajtjen e inflacionit mbi objektivin për një kohë më të gjatë. Në fakt, sipas projeksioneve të fundit të BQE-së, pritet që norma e inflacionit në vitin 2023 të jetë 5,6%, pas së cilës do të ngadalësohet dhe do të binte në 3,2% dhe 2,1% në vitin 2024 dhe 2025 në mënyrë përkatëse, që është një rishikim në rritje për vitin 2023 dhe 2024 dhe një rishikim në rënie për vitin 2025, në krahasim me qershorin¹. Sa u përket projeksioneve të rritjes ekonomike, ato janë rishikuar në rënie, me ç'rast pritet një rritje prej 0,7%, 1,0% dhe 1,5% më 2023, 2024 dhe 2025, në mënyrë përkatëse².

Treguesit më të fundit të ekonomisë vendase tregojnë një pasqyrë makroekonomike që është më së shumti në përputhje me projeksionet e prillit, ndonëse në disa segmente vërehen ulje. Në tremujorin e dytë të vitit 2023, rritja reale e PBB-së u ngadalësua, duke rënë në 1,1% me bazë vjetore (pas rritjes prej 2,1% në tremujorin e mëparshëm), që është afër rritjes së parashikuar për këtë tremujor nga cikli i projeksionit të prillit. E analizuar sipas komponentëve, rritja buron nga eksportet neto, e plotësuar nga kontributi i konsumit personal, i cili ngadalësohet gradualisht. Në bazë tremujore, PBB-ja shënoi një rritje reale minimale prej 0,2% (sipas të dhënave të EShS-së të rregulluara sezonale dhe kalendarike). Të dhënat e frekuencës së lartë për tremujorin e tretë të vitit 2023 që janë në dispozicion për momentin janë të pamjaftueshme për të kuptuar situatën në tërësi. Tani për tani, të dhënat e muajit korrik tregojnë lëvizje të vogla negative

¹ Në projeksionet e qershorit, normat e inflacionit prej 5,4%, 3,0% dhe 2,2% ishin parashikuar për vitin 2023, 2024 dhe 2025, në mënyrë përkatëse.

² Në projeksionet e qershorit, rritja e parashikuar e PBB-së ishte 0,9% në 2023 dhe 1,5% e 1,6% më 2024 e 2025, në mënyrë përkatëse.

në prodhimin industrial, si dhe një thellim mesatar të rënies reale të qarkullimit në tregtinë e përgjithshme. **Sa u përket ndryshimeve në çmimet e konsumit, në gusht të vitit 2023 norma vjetore e inflacionit vazhdon të ngadalësohet, duke rënë në 8,3% (8,4% në muajin paraardhës),** e cila është mbi vlerësimet e ciklit të projeksioneve të prillit, si pasojë e uljes së çmimeve të ushqimeve. Norma vjetore e inflacionit vazhdon të burojë kryesisht nga komponenti ushqimor, i cili ka kontributin më të madh, kurse komponenti bazë ka gjithashtu një kontribut të rëndësishëm. Nga ana tjetër, **dallimi në raport të inflacionit në Eurozonë** ngushtohet gjithashtu në muajin korrik, gjatë ngadalësimit më të theksuar të inflacionit vendor në krahasim me Eurozonën. Në të njëjtën kohë, rishikimet e lëvizjeve të pritshme në supozimet hyrëse të jashtme për projeksionin e inflacionit janë kryesisht në drejtim rënës. Megjithatë, pasiguria e dinamikës së ardhshme të çmimeve të produkteve parësore në bursa ekziston ende, gjatë efekteve të pasigurta ekonomike të luftës në Ukrainë, e cilat nuk qetësohet.

Analiza e treguesve të mjaftueshmërisë së rezervave valutore tregon që vazhdojnë të jenë në zonën e sigurt. Në lidhje me të dhënat më të fundit në dispozicion nga sektori i jashtëm, tani për tani deficit i tregtarit në korrik të vitit 2023 është më i ulët se sa pritej sipas projeksionit të prillit, por periudha e vlerësimit është shumë e shkurtër për të nxjerrë përfundime më të sakta. Të dhënat e operacioneve të këmbimit valutor në gusht të vitit 2023 tregojnë flukse hyrëse neto më të larta nga transferet private, krahasuar me projeksionin e prillit. Realizimet në bilancin e pagesave për tremujorin e dytë të vitit 2023 tregojnë një deficit më të ulët në llogarinë rrjedhëse, njëkohësisht gjatë realizimit të flukseve hyrëse financiare neto më të ulëta se sa pritej sipas parashikimit të prillit.

Në lidhje me **lëvizjet në sektorin monetar, depozitat** e përgjithshme në korrik të vitit 2023 janë më të larta për 11,2% me bazë vjetore, gjatë rritjes vjetore të projektuar për tremujorin e tretë prej 7,4% sipas projeksionit të prillit. Rritja e **totalit të kredive** të sektorit privat në korrik të vitit 2023 u ngadalësua, duke rënë në 5,8%, që është në përputhje me rritjen prej 5,7% të projektuar për tremujorin e tretë, sipas projeksionit të prillit. Të dhënat e anketës së aktivitetit kreditor për tremujorin e dytë të vitit 2023 tregojnë një farë shtrëngimi të kushteve në aspekt të ofertës së kredive në të dy sektorët, ndërkohë që kërkesa vazhdon të jetë më e dobët. Në të njëjtën kohë, rritja e kredive të reja të miratuara është ulur. Konkretisht, shuma e totalit të kredive të reja të miratuara të sektorit privat në 12 muajt e fundit është mesatarisht më e ulët në bazë vjetore, më e theksuar në kreditimin e sektorit të korporatave, e që është e pritshme dhe në përputhje me nevojat e rritura për likuiditet të kompanive në gjysmën e parë të vitit të kaluar, për shkak të krizës energjetike dhe rritjes së inventarëve.

Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në periudhën janar-korrik 2023 është realizuar deficit prej 27.033 milionë denarë. Deficiti buxhetor, në pjesën më të madhe, financohet nga huamarrja e shtetit në tregjet vendore dhe të jashtme, si dhe nga mjetet e depozitave të shtetit në Bankën Popullore. Deficiti buxhetor i realizuar për periudhën janar - korrik 2023 përfaqëson 63,2% të deficitit të planifikuar në Buxhetin e vitit 2023.

Të dhënat më të fundit në dispozicion për treguesit kyç makroekonomikë sugjerojnë që nevojitet një kujdes i mëtejshëm në politikëbërje, veçanërisht i theksuar në realizimet në inflacionin vendas. Inflacioni vendas në gusht të vitit 2023 vazhdon të ngadalësohet në bazë vjetore, por më i dobët, pra vazhdon të jetë në nivel relativisht të lartë, që ndikon edhe në pritshmëritë inflacioniste. Në kushtet e një rregullimi më të ndjeshëm në rënie të çmimeve të produkteve parësore në bursa, mbi të gjitha të ushqimeve, kalimi nga çmimet botërore në ato vendase është më i ngadalshëm dhe më i dobët. Edhe pse pritet ulje e mëtejshme e tyre, pasiguria e dinamikës së ardhshme të çmimeve të produkteve parësore në bursa vazhdon të ekzistojë për shkak të luftës në Ukrainë. Në tremujorin e dytë të vitit 2023, rritja ekonomike u ngadalësua, kurse shkalla e rritjes së PBB-së është afër pritshmërive. Të dhënat në dispozicion me frekuencë të lartë për tremujorin e tretë të vitit janë të kufizuara dhe të pamjaftueshme për vëzhgime më të sakta. Rezervat valutore vazhdojnë në nivelin e duhur, me lëvizje të favorshme në tregun valutor dhe një fluks të mëtejshëm të lartë hyrës të valutave në tregun valutor. Në sektorin monetar, sipas të dhënave


më të fundit, rritja e depozitave vijon të tejkalojë pritshmëritë, ndërsa rritja e kredive ngadalësohet në përputhje me projeksionin e prillit për tremujorin e tretë të vitit.

Bilanci i baraspeshuar i llogarisë rrjedhëse në gjysmën e parë të vitit 2023 - stabilizimi gradual pas goditjeve globale të çmimeve më 2022

Goditjet globale në një ekonomi të vogël dhe të hapur, si ajo maqedonase, përhapen shpejt në segmente të shumta të ekonomisë, që ishte veçanërisht e dukshme në vitin 2022. Kombinimi i goditjeve, çmimet e larta të karburanteve dhe të ushqimeve dhe karakteristikat specifike të ekonomisë sonë, siç është varësia e lartë energjetike, shkaktuan trysni të konsiderueshme importi dhe të larta tregtare, si dhe deficit në llogarinë rrjedhëse në gjashtëmujorin e parë të vitit të kaluar (4,8% e PBB-së). Në normalizimin e llogarisë rrjedhëse ndikuan stabilizimi gradual i çmimeve të importeve botërore dhe besimi kryesisht në rritje. Realizimet më të fundit për gjysmën e parë të vitit 2023 tregojnë një pozicion të baraspeshuar, pra një deficit të vogël prej 0,1% të PBB-së. Çmimet më të ulëta të karburanteve, si dhe ulja e kërkesës vendase për import të energjisë, çuan në një korrigjim të ndjeshëm në rënie të komponentit të importit. Për këtë arsye, në kushtet kur ka vazhdon të ketë realizime solide në eksport, erdhi te një ngushtim i ndjeshëm i deficitit në këmbimin e mallrave (me 5,2 p.p. të PBB-së), krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2022. Lëvizjet e favorshme në këmbimin e jashtëm tregtar u përcollën me realizime më të mirë të të ardhurave dytësore në gjashtëmujorin e parë të vitit 2023, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

NE llogaritjet e tregutve relevant, deri më 2021 është përdorur PBB nga niftimi zyrtar i ESHS. Për vitin 2022 përdoret njëri i parashikuar nga cilët i fundit i parashikimeve makroekonomike të BPRM-v-së.
/2 Te dhënat mujore për vitin 2021 janë të pamparshme, ndërsa për vitin 2022 janë të Verësura (Niftojnë për të dhënat tremujore për PBB për 2.3.2022). E dheja vjetore për 2020 është finale, ndërsa për vitin 2021 është e dhënë e pamparshme (Niftojnë për të dhënat vjetore për PBB për 30.9.2023).
/3 Normat e ndryshimit të Tregutit në profilin industrial janë bazë sipas 2015-100.
/4 Koshti e jetës të llogaritura sipas COICOP me bazë 2022=100.
/5 Norma për për të dhënat sipas shtetve i referohet dyfishit të vitit të rrethit/dyfishit të vitit të rrethit.
/6 Llogaritjet janë baze në pajtim me të dhënat nga metodologjia e re për përgatitjen e formave standarde të bilancave monetare dhe pasqyrave dhe plantat të re të përmbajtjes (që hapi në fuqi në gusht 2018).
/7 Përfinën depozitat e sektorit jashtëbankier në bankat dhe kurimet, depozitat e transferimeve të institucioneve tjera financiare në denari dhe depozitat e transferimeve të vetvetëgjatës lokale në denari.
/8 Data fillezr nga qershor 2018 dhe fundit të dhëna të normave të interesit shprehin të pasive janë sipas metodologjisë së re të BPRM.
/9 Bilanci tregtar në pajtim me statistikën tregtare të jashtme (në bazë c.i.f.).
/10 Te dhënat nga 2008 përforçim accruesit. Te dhënat e fundit të disponueshme për rezervat valutorë burime nga jete dhe jete të jashtme.
/11 Te dhënat për lagje punëtorë për 1.2023 nuk janë të balancuara me të dhënat nga burime tjera mund të jenë të gabuara, sepse prej arës së ESHS në 2023 është implementuar rregullorja e re e BE-së. Aplikimi i rregullores se re shkaktoi ndryshime në humnitimin, dala fillezr me ndryshime në duzinjën e pyetitort, ndryshimin e renditjes së pyetjeve, ndryshime dhe largim të pyetjeve ekzistuese dhe shtimi i pyetjeve të reja, ndryshime në përfaqësimin e kategorisë dhe paqendrueshmërisë.


Kërkesa e huaj efektive (ndryshime vjetore në %)



Rishikime në rënie ka në pritshmëritë për rritjen e **kërkesës së huaj**, për shkak të pritshmërive të përkeqësura për vitin 2024 (rritje prej 1,3%, në vend të 1,7%), nën ndikimin e rritjes më të ulët të ekonomisë gjermane³.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe llogaritjet e BPRMV-së.


Kërkesa e huaj efektive (ndryshime vjetore në %)



Rishikime në rritje ka në **inflacionin efektiv të huaj**, para së gjithash për vitin 2023 (7,5%, në vend të 6,9%), gjatë pritshmërive për inflacion më të lartë të shumë prej partnerëve tanë të importit.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Kursi euro/USD-dollar




Pritet një zhvlerësim i mëtejshëm i Pritet një nënçmim i mëtejshëm i dollarit amerikan ndaj euros.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe llogaritjet e BPRMV-së.

³ Është projektuar tkurrja e Gjermanisë për 0,3% më 2023 dhe rritja për 0,9% më 2024, në mënyrë përkatëse, kundrejt -0,1% dhe 1,4% në prill.

Nafta "brent"


(mesatarja tremujore, euro/fuçi)



Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Çmimet e nikelit dhe bakrit në euro


(ndryshime vjetore në %)



Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Çmimet e grurit dhe misrit në euro

(ndryshime vjetore në %)




Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Bëhen rishikime kryesisht në rënie në çmimet e prodhimeve parësore⁴, si një pasqyrim i pritshmërive për një aktivitet më të dobët ekonomik global (kryesisht për shkak të Kinës)...

... me përjashtim të çmimit të **naftës**, për shkak të shqetësimeve për një ofertë më të dobët, krahasuar me pritjet e mëparshme.

⁴ Për analizën e çmimeve të naftës, metaleve dhe produkteve ushqimore parësore përdoren raporte të ndryshme të FMN-së, Bankës Botërore, FAO, OPEC, BQE-së dhe portaleve të specializuara ekonomike ndërkombëtare.


Euribor-i njëmuor (mesatarja tremujore, në %)



Burimi: "Consensus Forecast" dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Në EURIBOR-in njëmuor ka rishikime në rritje, në përputhje me dinamikën e shtrëngimit të politikës monetare nga BQE-ja.

Indeksi Financiar i stresit




Treguesi i stresit financiar global, i cili vlerëson gjendjen e tregjeve financiare, sugjeron rreziqe të ulëta financiare⁵.

⁵ Indeksi KFI IFS (ang. OFR FSI) mat stresin financiar sistemor - shqetësimet në funksionimin normal të tregjeve financiare. Ai përbëhet nga 33 variabla të tregut financiar, të përmbledhura në pesë kategori treguesish: kredia, vlerësimi i kapitalit, financimi, aktivet e sigurta/pa rrezik dhe paqëndrueshmëria. Vlera e indeksit në një ditë të caktuar përfaqëson një nivel mesatar të ponderuar të çdo variable të vëzhguar në treg atë ditë, në raport me vlerën e tij historike, me indeksin pozitiv – kur niveli i stresit është mbi mesataren, si dhe negativ – kur niveli i stresit është nën mesataren.

Norma e infalcionit

(kontributet vjetore në inflacionin total, në p.p.)




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Në gusht të vitit 2023, çmimet e konsumit vendas u rritën për 1,2% me bazë mujore, që më së shumti vjen si pasojë e rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore prej 2,0% (kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve të perimeve dhe të bulmetit).

Gjithashtu, çmimet e energjisë shënuan rritje mujore prej 1,4%, si rezultat i rritjes së çmimeve të derivateve të naftës në përputhje me lëvizjet e bursave botërore.

Inflacioni dhe çmimet e ushqimit dhe energjisë


(ndryshimet vjetore, në %)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Inflacioni bazë në gusht shënoi rritje prej 0,5% në bazë mujore, nën ndikimin e rritjes sezonale të çmimeve të transportit ajror.


Kontributet në normën vjetore të inflacionit (në p.p.)



Burimi: EShS-ja dhe BPRMV-

Shkalla vjetore e inflacionit në gusht ishte 8,3% (8,4% në muajin paraardhës), ndërkaj kontributin më të madh vazhdon ta ketë komponenti ushqimor. Rritja e komponentit bazë është ulur në 7,1% me bazë vjetore (7,4% në muajin paraardhës).


Diferenca ndërmjet inflacionit vendas dhe inflacionit në Eurozonë (në p.p.)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe Eurostat.

Dallimi në raport me inflacioni në Eurozonë⁶ zvogëlohet dhe në korrik, gjatë ngadalësimit më të theksuar të inflacionit vendas.


Pritshmëritë e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve në 12 muajt e ardhshëm (bilance të përgjigjeve)



Burimi: Komisioni European

Pritshmëritë e konsumatorëve⁷ tregojnë lëvizje të lehtë në rritje të çmimeve...

Norma mesatare e pritshme e inflacionit (në %)




... **pritshmëritë e analistëve vendas ekonomikë⁸** janë në rënie dhe tregojnë një ngadalësim gradual të shkallës vjetore të inflacionit në periudhën e ardhshme.

⁶ Në bazë të indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit, për të cilin të dhënat e fundit të publikuara për vendin janë për korrikun.

⁷ Anketa e Optimizmit të Konsumatorëve të Komisionit European, e gushtit të vitit 2023, në bazë të pyetjes "pritshmëritë e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve gjatë 12 muajve të ardhshëm".

⁸ Anketa e pritshmërive inflacioniste dhe pritshmëritë e PBB-së, zbatuar nga BPRMV-ja, qershor 2023.

Parashikimet inflacionare të udhëheqësve të ndërmarrjeve për 3 muajt e ardhshëm
(bilancet e përgjigjeve)




Burimi: Komisioni European

Sa u përket **pritsmërive të sektorit të korporatave⁹**, në industrinë e përpunimit, tregtinë me pakicë dhe ndërtim, pritet rritje e çmimeve, ndërsa në sektorin e shërbimeve pritet rënie.

Shkalla e inflacionit vjetor të realizuar në gusht është më e lartë se shkalla e projektuar nga cikli i projeksioneve të prillit, si pasojë e uljes në komponentin ushqimor.

Rishikimet e **lëvizjeve të pritshme të supozimeve hyrëse të jashtme** në projeksionin e inflacionit janë kryesisht në drejtimin rënës, me përjashtim të inflacionit të jashtëm efektiv, i cili ka një ndryshim në rritje, si dhe çmimit të naftës për vitin 2024. Vazhdon të ekzistojë pasiguria e dinamikës së ardhshme të çmimeve të produkteve parësore në bursa.


Çmimet e huaja efektive* dhe të brendshme të ushqimit dhe pijet joalkoolike (treguesi, 2015= 100)



* Çmimet e huaja efektive të ushqimit janë marrë si përmblendje e ponderuar nga çmimet e ushqimit në vendet që janë partnerë më të rëndësishëm tregtar të Maqedonisë së Veriut në fushën e importit të ushqimit.

Burimi: EShS-ja, Eurostat dhe logaritmet e BPRMV-së.

Paga mesatare e paguar
(normat vjetore, në %)



Burimi: EShS-ja.


Në qershor 2023, shënohet një rritje minimale mujore e **rrogës mesatare nominale neto** dhe një ngadalësim i rritjes vjetore....

... gjatë ngadalësimit të rritjes vjetore të rrogave në veprimtaritë e shërbimeve dhe në bujqësi, ndërsa në industri dhe ndërtim vërehet një përshpejtim i rritjes së rrogave....

... por përshpejton rritjen e **rrogës reale neto**, me një ngadalësim më të madh të inflacionit në raport me ngadalësimin e rritjes nominale të rrogave.


⁹ Anketa e prirjeve biznesore të Komisionit European në industri, tregti me pakicë, ndërtim dhe sektorin e shërbimeve.

Paga mesatare mujore neto e paguar sipas sektorëve
(normat nominale vjetore, në %)



Burimi: EShS-ja.

Prodhimi i brendshëm bruto
(normat reale vjetore, në %)



Burimi: EShS-ja dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Dallimet në seri në periudhën e arritur janë për shkak të rishikimeve të rregullta të EShS-së.

Ndryshimi nominal dhe real vjetor i realizuar i rrogave në tremujorin e dytë të vitit 2023 kryesisht është në përputhje me projeksionin e prillit.

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, rritja reale e PBB-së u ngadalësua lehtësisht dhe është 1,1% me bazë vjetore, ndërkohë që është afër rritjes së projektuar për këtë tremujor nga cikli i projeksionit të prillit.

Nga këndvështrimi prodhues i PBB-së, rritja vijon të jetë si rezultat i kontributit pozitiv të grupit të aktiviteteve të "tregtisë, transportit dhe hotelierisë".

Nga këndvështrimi i shpenzimeve të PBB-së, rritja rezulton nga eksportet neto, të plotësuar nga kontributi i konsumit personal. Ngadalësimi i rritjes vjen si pasojë e kontributit më të ulët të eksporteve neto (kryesisht për shkak të rënies së eksporteve pas rritjes në tremujorët e mëparshëm dhe pjesërisht rënies së ngadaltë të importeve), si dhe nga ngadalësimi i rritjes së konsumit personal.

Në bazë tremujore, PBB-ja shënon rritje reale minimale prej 0,2%¹⁰.


Në kushtet e vëllimit të kufizuar të të dhënave në dispozicion, është e vështirë të jepet një vlerësim i saktë i gjendjes së përgjithshme të ekonomisë në tremujorin e tretë të vitit 2023.

Rezultatet e hulumtimeve për periudhën korrik - gusht 2023 tregojnë perceptime më të favorshme në raport me tremujorin e tretë të vitit

¹⁰ Sipas të dhënave të rregulluara sezonale dhe kalendarike të EShS-së.



Në korrik, në **totalin e qarkullimit tregtar** vërehet një thellim mesatar i rënies reale me bazë vjetore, nën ndikimin e tregtisë me pakicë dhe tregtisë me shumicë.




Në korrik vihet re një efekt sezonal më i theksuar në **prodhimin industrial**, i cili çon në një rënie të vogël reale me bazë vjetore, në krahasim me rritjen e tremujorit paraardhës. Duke parë aktivitetet, rënia është e shpërndarë.

*Rritjet reale të rritjes logaritike nga BPRM-ja, duke përfshirë normat nominale të rritjes me inflacionin vijtor, të matur sipas sferëzimeve të jetësës. Të dhënat e tregtisë në 2020, 2021, 2022 dhe 2023 janë të dhëna paraprake, ndërsa të dhënat e PBB-së në 2021 janë të mëparshme ndërsa për PBB-në në 2022 dhe 2023 janë vlerësuar.

13 nga 30

Treguesit e lëvizjes së konsumit personal
(normat reale vjetore, në %)




Burimi: ESHS-ja dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Treguesit në dispozicion të **kërkesës agregate** janë gjithashtu relativisht të kufizuar, që e bën të pamundur formimin e një vlerësimi më të saktë të lëvizjes së komponentëve individualë të kërkesës në tremujorin e tretë të vitit 2023.

Të dhënat në dispozicion për lëvizjet e **konsumit personal** për korrikun e vitit 2023 tregojnë kryesisht një ngadalësim të rritjes së tij gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023, i nxitur mbi të gjitha nga rënia relativisht e lartë e prodhimit vendas të mallrave të konsumit, tregtisë me pakicë dhe të të hyrave bruto nga TVSh-ja.

Treguesit e lëvizjes së investimeve bruto
(normat reale vjetore, në %)



Burimi: ESHS-ja dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Sa u përket të dhënave me frekuencë të lartë të korrikut për **investimet bruto**, sinjalet janë të ndryshme...

... me rënie të prodhimit të përgjithshëm industrial, importit të kapitalit qarkullues dhe tatimit në fitim, si dhe me lëvizje pozitive në prodhimin vendas të mallrave kapitale, investimet kapitale shtetërore (në lidhje me pagesat paraprake për projekte infrastrukturore) dhe mbështetje kreditore për ndërmarrjet.

Të dhënat e **këmbimit tregtar të jashtme** në korrik të vitit 2023 tregojnë një ngushtim të mundshëm të deficitit, krahasuar me të njëjtin periudhë të vitit të kaluar, me rritje nominale të eksporteve dhe rënie të importeve të mallrave.

Realizimet buxhetore në përputhje me të dhënat fiskale të korrikut të vitit 2023 tregojnë për një rritje reale vjetore të konsumit publik.

Tregu i punës¹² në tremujorin e dytë të vitit 2023 shënoi lëvizje pozitive në bazë tremujore...

... **shkalla e punësimit** u rrit për 0,4 p.p. dhe është 45,5%, në kushtet e rritjes prej 0,9% të


¹² Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2023 nuk janë të krahasueshme me të dhënat e tremujorëve të mëparshëm të viteve të tjera sepse në vitin 2023 u zbatua Rregullorja e re (BE) nr. 2019/1700 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të Statistikave Sociale dhe rregullorja ekzekutive përkatëse e Komisionit (BE) nr. 2019/2240 për fushën e fuqisë punëtore, ndërsa Rregullorja e mëparshme (KE) nr. 577/98 u shfuqizua. Zbatimi i rregullores së re shkaktoi ndryshime në anketë, duke filluar nga ndryshimet në hartimin e pyetësorit, ndryshimi i renditjes së pyetjeve, ndryshimet dhe heqja e pyetjeve ekzistuese dhe shtimi i pyetjeve të reja, ndryshime në shtrirjen dhe përcaktimin e punësimit dhe të papunësisë. Prandaj, në këtë informacion ne bëjmë një analizë vetëm në bazë të të dhënave të krahasueshme të vitit 2023, pra një analizë të ndryshimeve tremujore.

numrit të të punësuarve në krahasim me tremujorin paraardhës....

...**shkalla e papunësisë** shënoi rënie të mëtejshme dhe u ul në 13,1%, ndërsa numri i të papunëve u ul për 0,5%.

Nga aspekti i ofertës së fuqisë punëtore, tremujori i dytë shënoi rritje të popullsisë aktive (për 0,8%), për llogari të rënies së popullsisë joaktive (për 0,7%).

Eksport sipas komponentave (kontribute në ndryshimin vjetor, në p.p.)




Извор: НБРСМ.

Deficiti në shkëmbimin e mallrave me vendet e huaja në korrik të vitit 2023 u ul për 25,4% me bazë vjetore, nën ndikimin e uljes së importit të mallrave, me një rritje të vogël të eksportit të mallrave.

Eksporti i mallrave në korrik të vitit 2023 shënoi rritje prej 4% me bazë vjetore, me eksporte më të larta të kompanive nga industria e automjeteve dhe eksporte më të larta të energjisë elektrike. Realizimet e eksportit tani për tani janë në linjë me projeksionin e prillit.


Import sipas komponentave (kontribute në ndryshimin vjetor, në p.p.)



Извор: НБРСМ.



Importet e mallrave në korrik të vitit 2023 shënuan rënie prej 4,5% me bazë vjetore, me një import të reduktuar të energjisë, pajisjeve dhe makinerive. Krahasuar me projeksionin e prillit, realizimet në import janë më të ulëta.


Deficiti tregtar në korrik të vitit 2023 tani për tani është më i ulët se pritshmëritë e tremujorit të tretë të vitit sipas projeksionit të prillit.



Në korrik të vitit 2023, indekset e REDK u rritën në bazë vjetore, kryesisht nën ndikimin e mbivlerësimit të NEDC (zhvlerësimi i lirës turke kundrejt valutës vendase), me harxhime të pandryshuara relative të jetesës dhe rritje të vogël të çmimeve relative të produkteve industriale.


Lëvizje të ngjashme mbivlerësuese në indekset e REDK-së vërehen edhe sipas llogaritjes me ponderë në bazë të këmbimit tregtar të jashtëm, pa produktet parësore, por pak më mesatare.



Komponentët e llogarisë rrjedhëse
(në milionë euro)


Në tremujorin e dytë të vitit, llogaria rrjedhëse realizoi deficit prej 116,9 milionë euro ose 0,8% të PBB-së, që është më e ulët se sa pritej sipas projeksionit të prillit....

... me një deficit tregtar më të ulët se sa pritej (import më i ulët i mallrave) dhe një suficit më të lartë në të ardhurat dytësore (transferet private më të larta).

Komponentët e llogarisë rrjedhëse
(në milionë euro)

Në llogarinë financiare janë realizuar hyrje neto¹³ prej 152,6 milionë euro (ose 1,1% të PBB-së), më të ulëta në raport me pritshmëritë sipas projeksionit të prillit


Lëvizjet e tregut të këmbimit



Blerja neto në tregun valutor, e realizuar në periudhën 1 korrik - 31 gusht 2023, është afërsisht në nivelin e vitit të kaluar, kurse realizimet e deritashme tregojnë realizime më të favorshme në transferet private në krahasim me projeksionin e prillit.

¹³ Sipas metodologjisë së re për përgatitjen e bilancit të pagesave (BPM6), termat hyrje neto dhe dalje neto nënkuptojnë krijimin neto të detyrimeve dhe blerjen neto të mjeteve.

Rezerva valutore bruto
(gjendja në milionë euro)




*Të dhënat e fundit të disponueshme: 30.08.2023

Gjendja e rezervave valutore bruto në fund të gushtit të vitit 2023 është 3.934,2 milionë euro.


Rënia në raport me fundin e tremujorit të dytë vjen si pasojë e transaksioneve për llogari të shtetit (shlyerja e euroobligacionit).

Faktorë të ndryshimit të rezervave valutore në Korrik dhe Gusht të vitit 2023
(në milionë euro)




Burimi: BPRMV.

Tregu valutor
(në milionë euro)



Struktura e tregut valutor
(shitja/blerja neto, në milionë euro)

ndryshim vjetor
VII+VIII 2023 -
VII+VIII
2022
në mil. euro




Burimi: BPRMV.

Analiza sektorale tregon se zhvendosje të këtilla të tregut valutor burojnë nga blerjet neto nga jorezidentët dhe persona fizikë.

Instrumentet e politikës monetare

(stoqet, të dhënat e fundit të muajit, në milionë denarë)




Burimi: BPRMV.


Gjendja e instrumenteve monetare në fund të korrikut të vitit 2023 shënon rënie, krahasuar me muajin paraardhës, e cila është për shkak të sasisë së reduktuar të mjeteve bankare të vendosura në depozita në dispozicion në Bankën Popullore.

Niveli i instrumenteve monetare në fund të korrikut është më i ulët, krahasuar me nivelin e projektuar në fund të tremujorit të tretë të vitit 2023, me një aktiv neto valutor më të ulët të Bankës Popullore dhe një zhvendosje më të madhe në rënie në totalin e depozitave të shtetit, ndërsa realizimet në paratë primare janë afër atyre të projektuara.

Depozita në tota
(kontribute në p.p., ndryshime mujore)




(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)




- Depozita të sektoreve tjera*
- Depozita në valutë të huaj
- Depozita të ndërmarrjeve
- Depozita, / ndryshim mujore/vjetor, në %
- Depozita në valutë të brendshme
- Para të depozituara
- Depozita të amvisërive
- Depozita, / ndryshime vjetore, në %

*Në depozita të sektoreve tjera janë të përfshira depozita të institucioneve financiare tjera, depozitat e vetëqeverisjes lokale dhe depozitat e institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërive të bankat, si dhe depozitat e transferueshme në denarë të institucioneve tjera financiare dhe të vetëqeverisjes lokale të Banka Popullore

Depozita të amvisërive
(kontributet në p.p., ndryshimet mujore)



(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)



Burimi: BPRMV.

Rritje e vogël mujore e **gjithsej depozitave**¹⁴ në **sistemin financiar** ka në korrik të vitit 2023, nën ndikimin e depozitave të korporatave dhe me një kontribut të barabartë të depozitave me valutë vendase dhe valutore.


Totali i depozitave në korrik të vitit 2023 shënoi rritje krahasuar me tremujorin e dytë, që tani për tani është brenda rritjes së pritshme për tremujorin e tretë, në përputhje me projeksionin e prillit.

Shkalla vjetore e rritjes së gjithsej depozitave në korrik të vitit 2023 është 11,2%, ndërsa shkalla e parashikuar për tremujorin e tretë të vitit 2023 është 7,4%.

Rritje minimale mujore të **depozitave të amvisërive** ka në korrik të vitit 2023, me një rritje të mëtejshme të depozitave afatgjata dhe depozitave në valutë vendase. Në bazë vjetore, depozitat e amvisërive në korrik të vitit 2023 janë më të larta për 8,4%.

¹⁴ Të dhënat u referohen depozitave të sektorit jostetëror në banka dhe kursimore, mjeteve të institucioneve të tjera financiare në llogaritë pranë BPRMV-së dhe mjeteve të njësive të vetëqeverisjes vendore në llogaritë pranë BPRMV-së. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të BPRMV-së të qershorit 2018. Më shumë informacion rreth ndryshimeve metodologjike mund të gjeni në këtë vjeggëz: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nsp.x.

Depozita në denarë dhe valutë të amvisërive/totali i depozitave të amvisërive
(pjesëmarrje në fund të muajit, në përqindje)




*Totali i depozitave vetëm në banka dhe kursimoret.

Burimi: BPRMV.

Lëvizjet në strukturën valutore të gjithsej depozitave të amvisërive, nga dhjetori i vitit 2022 e në vazhdim, tregojnë forcimin e denarizimit.

Oferta monetare M4

(kontribute në p.p., ndryshime mujore)




Burimi: BPRMV.

Paraja e gjerë e shprehur përmes agregatit monetar më të gjerë M4, në korrik të vitit 2023, realizoi rritje të vogël mujore prej 0,6%, gjatë rritjes në të gjithë komponentët e strukturës së maturimit dhe të valutave të parasë së gjerë, me përjashtim të rënies së parave të depozituara.


Rritja vjetore e parasë së gjerë në korrik të vitit 2023 u ngadalësua lehtë dhe është 10,6%, me një rritje vjetore prej 7,3% të projektuar për tremujorin e tretë të vitit 2023, sipas projeksionit të prillit.

Pjesëmarrje e M4 pjesë në denarë në totalin e ofertës monetare M4
të dhënat në fund të muajit, në %




Pjesëmarrja e pjesës në denarë në ofertën e përgjithshme monetare M4 në fund të korrikut të vitit 2023 është 60,4%.

të dhënat në fund të vitit, në%



Burimi: BPRMV.


Kredite në total
(kontribute në p.p., ndryshime mujore)



Kreditë e përgjithshme në korrik u ulën për 0,2%, gjatë kontribut negativ të kredive të ndërmarrjeve, si dhe të kredive në valutë vendase dhe të huaj.

Në korrik të vitit 2023, ndryshimi në totalin e kredive, krahasuar me fundin e tremujorit të dytë, tani për tani është më i dobët sesa rritja e projektuar për tremujorin e tretë të vitit 2023, sipas projeksionit të prillit.


(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)



Shkalla vjetore e rritjes së totalit të kredive në korrik ishte 5,8%, që është në përputhje me rritjen vjetore prej 5,7% të projektuar për tremujorin e tretë të vitit 2023, sipas projeksionit të prillit.


Burimi: BPRMV.

Kredi të reja të sektorit privat, 12M mesatarja lëvizëse, norma vjetore të rritjes




Shuma e totalit të kredive të reja të miratuara të sektorit privat në 12 muajt e fundit është mesatarisht më e ulët në bazë vjetore, më e theksuar në kreditimin e sektorit të korporatave, e që është e pritshme dhe në përputhje me nevojat e rritura për likuiditet të kompanive në gjysmën e parë të vitit të kaluar, për shkak të krizës energjetike dhe rritjes së inventarëve.


Kredi të reja të amvisërive, 12M mesatarja lëvizëse, norma vjetore të rritjes



Kredi të reja të ndërmarrjeve, 12M mesatarja lëvizëse, normat vjetore të rritjes




Raporti ndërmjet kredive totale dhe depozitave (të dhënat mujore, në përqindje)




Shfrytëzimi i potencialit depozitues për kreditimin e sektorit privat është ulur lehtësisht në muajin korrik dhe është nën vlerën e këtij treguesi të projektuar për fundin e tremujorit të dytë të vitit 2023, sipas projekcionit të prillit.

(Të të dhënat vjetore, në përqindje)




Извор: BPRMV.

Norma e interesit të totalit të depozitave
(të dhëna mujore, në përqindje)




(Të dhënat në fund të vitit, në përqindje)




Burimi: BPRMV-ja

Në korrik të vitit 2023, normat e interesit të totalit të depozitave (në denarë dhe në valuta¹⁵ lëvizën në linjë në rritje, kurse dallimi i normës është stabil. Pas rritjes së lartë në qershor, në **totalin e depozitave të pranuar të reja**¹⁶, lëvizjet e normave të interesit janë në rënie dhe dallimi i interesit shënoi ngushtim...

Norma e interesit të totalit depozita të amvisërive
(të dhënat mujore, në përqindje)



(të dhënat në fund të vitit, në përqindje)




Burimi: BPRMV-ja

... ndërkaj lëvizje të ngjashme vërehen në normat dhe dallimet përkatëse të interesit në sektorin e "amvisërive".


¹⁵ Të dhënat e normave të interesit janë në përputhje me ndryshimet metodologjike të BPRMV-së të qershorit 2018. Më shumë informacion rreth ndryshimeve metodologjike mund të gjeni në këtë vjeggëz: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspk.

¹⁶ Sa u përket normave të interesit të depozitave të reja, duhet pasur parasysh që karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit të depozitave të pranuar të reja rezultojnë nga fakti që kushtëzohen nga vëllimi i depozitave të pranuar të reja (që mund të ndryshojnë nga muaji në muaj) dhe norma e tyre e interesit.

Norma e interesit të totalit të kredive sipas sektorëve
(ndryshime mujore në përqindje)




(Të dhënat në fund të vitit, në përqindje)



Burimi:
RPRMV-ia

Në korrik të vitit 2023 vërehet lëvizje në rritje edhe në normat e interesit të **totalit të kredive të amvisërive dhe totalit të kredive të ndërmarrjeve**. Ndryshim në rritje ka edhe në normat e interesit të **kredive të miratuara të reja**¹⁷ të ndërmarrjeve pa ndryshime në të amvisërive.

Normat e interesit bazë të BPRMV-së dhe BQE-së (në%) dhe diferenca e tyre (në p.p.)




Shtërngimi i politikës monetare vendase në periudhën e fundit ndjek dinamikën e shtërngimit të BQE-së, ndërkohë që dallimi i normave të interesit është e qëndrueshme.


¹⁷ Sa u përket normave të interesit të kredive të reja të miratuara, duhet pasur parasysh që karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit të kredive të reja të miratuara rezulton nga fakti që kushtëzohen nga vëllimi i kredive të reja të miratuara (që mund të ndryshojnë nga muaji në muaj) dhe norma e tyre e interesit.

Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore

(kontribute në ndryshimin vjetor, në p.p.)




Në korrik të vitit 2023 u shënua rritje dukshëm më e fortë e shpenzimeve sesa rritja e të hyrave në buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (buxheti qendror dhe buxhetet e fondeve), gjatë harxhimeve të larta kapitale.



Në periudhën janar - korrik 2023, të hyrat totale buxhetore janë më të ulëta për 11,9%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa shpenzimet totale buxhetore janë më të larta për 22,5%...

Realizimi i Buxhetit, sipas kategorive

(Buxheti qendror dhe fondet), në përqindje nga plani vjetor





... ndërkaq deficitin buxhetor i realizuar prej 27.033 milionë denarë përfaqëson 63,2% të deficitit të planifikuar në Buxhetin e vitit 2023¹⁸...

Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.


¹⁸ "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 282, datë 7.12.2022.

... dhe financohet nëpërmjet huamarrjes neto të shtetit tregun vendas dhe të huaj¹⁹, si dhe nga mjetet e depozitave të shtetit pranë Bankës Popullore.



Në korrik të vitit 2023, në ankandet e rregullta, Ministria e Financave mbajti të njëjtat norma interesi për letrat me vlerë të sapoemetuar dhe për herë të parë u emetua një obligacion civil dyvjeçar pa klauzolë valutore, me normë interesi prej 5%.

¹⁹ Në mars u emetua euroobligacioni i nëntë në vlerë prej 500 milionë euro, me kupon interesi prej 6,96% dhe me afat maturimi katërvjeçar. Në korrik është paguar plotësisht euroobligacioni i emetuar në korrik të vitit 2016, në vlerë prej 450 milionë euro, për 7 vite dhe me normë interesi prej 5,625%.



Burimi: Llogaritjet e BPRMV-së në bazë të të dhënave nga Ministria e Financave.

Rritje të vogël e **borxhit publik**²⁰ ka në fund të tremujorit të dytë të vitit 2023, nën ndikimin e rritjes së borxhit vendas publik.

²⁰ Borxhi publik përkufizohet me Ligjin e Borxhit Publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së" numër 62/2005, 88/2008, 35/2011, 139/2014 dhe 98/2019) sipas të cilit ai përfaqëson shumën e borxhit shtetëror dhe të borxhit të ndërmarrjeve publike të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit, si dhe shoqëritë tregtare që janë në pronësi të plotë ose dominuese të shtetit ose komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe në Qytetin e Shkupit.

Shtojca 1: Kategoritë treguese për konsumin personal dhe investimet bruto

KATEGORITË INDIKATIVE TË KONSUMIT PERSONAL

	2020				2021				2022				2023		
	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4	tr.1	tr.2	korrik
	<i>ndryshime reale vjetore në %</i>														
Qarkullim në tregtinë me pakicë*	1,0	-18,6	-15,7	-15,5	-1,3	18,3	13,9	10,0	7,6	6,7	1,9	-3,7	1,4	-8,1	-11,3
Të hyra bruto nga TVSh-ja*	1,8	-20,0	-10,8	-4,2	2,9	36,6	21,1	20,6	29,2	9,5	3,7	-7,7	-15,0	-9,5	-7,64
Import i mallrave për konsum të gjerë*	6,9	-12,4	-3,6	-9,4	3,2	26,2	11,4	13,9	-2,9	-1,5	-2,2	-10,1	2,0	4,7	3,9
Prodhimi i brendshëm i mallrave të konsumit	-0,5	-22,4	-9,3	-12,1	-9,4	17,1	-5,6	5,1	2,2	-1,2	3,3	-3,6	6,4	4,9	-14,4
Kreditë e popullsisë*	9,7	6,3	6,2	4,5	4,7	5,7	4,0	3,2	-0,5	-5,6	-9,2	-9,3	-6,6	-2,4	-1,7
Paga mesatare neto*	10,0	4,6	7,0	4,7	2,0	5,7	1,1	0,7	0,0	-1,7	-4,6	-4,6	-2,8	3,6	-
Transferimet neto private*	-2,0	-38,0	-34,9	-10,2	9,5	66,5	55,5	14,2	9,8	25,1	11,8	4,8	11,3	-9,2	-
Pensionet*	5,7	6,2	5,3	5,4	2,3	0,3	0,0	-1,8	-3,4	-1,0	-10,4	-4,9	-2,5	1,3	10,4

*rritjet reale të rritjes llogariten nga BPRMV-ja, duke pjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, të matur sipas shpenzimeve të jetesës.

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.

KATEGORITË INDIKATIVE PËR INVESTIMET

	2020				2021				2022				2023		
	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4	tr.1	tr.2	tr.3	tr.4	tr.1	tr.2	јули
	<i>ndryshime reale vjetore në %, përveç për SDI ndryshimet në shumat reale janë në miliona denarë</i>														
Import i mjeteve për punë*	1,0	-34,5	-3,0	4,4	8,9	64,2	6,5	4,7	6,8	5,5	10,8	-1,4	-3,8	-1,9	-12,3
Punimet e realizuara ndërtimore**	6,3	-5,1	3,0	2,3	-1,1	-9,6	-10,8	-17,5	-11,1	-1,2	-19,2	-14,0	14,7	-21,2	-
Prodhimi i brendshëm i produkteve kapitale	-5,7	-46,0	-9,0	1,0	-7,3	59,6	-24,3	-22,3	0,9	3,3	18,6	3,7	6,7	8,2	28,0
Investime shtetërore kapitale*	23,8	-34,4	26,0	-20,7	166,5	3,7	56,2	9,3	-16,4	25,0	-47,3	55,6	-6,8	313,1	159,5
Investime direkte***	4668,1	-2737,5	-6616,2	-10681,2	-10610,7	15231,4	1550,0	9560,3	9032,6	-5832,2	9936,2	763,8	97,6	-2799,8	-
Kredi afatgjatë të ndërmarrjeve*	4,1	8,2	11,5	5,8	7,3	2,5	0,7	3,9	2,2	-2,2	-6,5	-6,7	-5,0	1,2	2,1
Inventari i produkteve të gatshme	9,0	15,7	2,6	-8,0	2,0	9,7	16,1	12,4	11,5	9,2	11,1	10,5	-3,1	-5,5	-

*rritjet reale të rritjes llogariten nga BPRMV-ja, duke pjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, të matur sipas shpenzimeve të jetesës.

**rritjet reale të rritjes përtohen duke përdorur normën e rritjes së deflatorit të shpenzimeve të ndërtimit të banesave të reja.

***shumat reale llogariten nga BPRMV-ja, duke pjesëtuar shumatat nominale me nivelin e indeksit të çmimeve të konsumit (viti bazë: 2022= 100).

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.